



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.59

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9532 datë 15.5.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e Strasburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave, 1979”.....	1659
Dekret nr.4906 datë 6.6.2006	Për emërim ambasadori.....	1667
Dekret nr.4907 datë 6.6.2006	Për emërim ambasadori	1667

L I G J
Nr.9532, datë 15.5.2006

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN E STRASBURGUT
PËR KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR TË PATENTAVE, 1979”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen e Strasburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave, 1979”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4895, datë 2.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJA E STRASBURGUT
MBI KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR TË PATENTAVE
E DATËS 24 MARS 1971, AMENDUAR MË 28 SHTATOR 1979

Palët,

duke e konsideruar miratimin universal të një sistemi uniform të klasifikimit të patentave, certifikatave të shpikësve, certifikatat e modeleve të përdorimit në interesin e përgjithshëm si kusht për të vendosur një bashkëpunim më të ngushtë në fushën e pronësisë industriale dhe kontribuar mbi harmonizimin e legjislacionit kombëtar në këtë fushë;

duke njohur rëndësinë e Konventës Europiane mbi klasifikimin ndërkombëtar të patentave për shpikjet të 19 dhjetorit 1954, me të cilën Këshilli i Europës krijoi klasifikimin ndërkombëtar për patentat për shpikjet;

duke pasur parasysh vlerën universale të këtij klasifikimi dhe rëndësinë e tij për të gjitha shtetet palë të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale;

duke pasur parasysh rëndësinë për vendet në zhvillim të këtij klasifikimi, që u jep atyre akses më të lehtë në vëllimin gjithnjë në rritje të teknologjisë moderne;

duke pasur parasysh nenin 19 të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale të 20 marsit 1883, amenduar në Bruksel më 14 dhjetor 1900, Uashington më 2 qershor 1911, Hagë më 16 nëntor 1925, Londër më 2 qershor 1934, në Lisbonë më 31 tetor 1958 dhe në Stokholm më 14 korrik 1967,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Themelimi i një unioni special: miratimi i një klasifikimi ndërkombëtar

Vendet për të cilat kjo Marrëveshje zbatohet përbëjnë një bashkim special dhe miratojnë një klasifikim të përbashkët për patentat për shpikje, certifikatat e shpikësve, certifikatat e modeleve të përdorimit dhe certifikatat e përdorimit, e njohur si “Klasifikimi Ndërkombëtar i Patentave” (më poshtë referuar si “Klasifikimi”).

Neni 2

Përkufizimi i Klasifikimit

1.a) Klasifikimi përmban:

i) tekstin e vendosur në lidhje me dispozitat e Konventës Europiane për klasifikimin ndërkombëtar të patentave për shpikjet më 19 dhjetor 1954 (më poshtë referuar si “Konventa Europiane”) dhe që hyri në fuqi dhe u bë publike nga Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës më 1 shtator 1968;

ii) amendamentet që hynë në fuqi në lidhje me nenin 2(2) të Konventës Europiane përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

iii) amendamentet e bëra më pas në përputhje me nenin 5 që hyn në fuqi në lidhje me dispozitat e nenit 6.

b) Udhëzuesi dhe shënimet e përfshira në tekstin e Klasifikimit janë pjesë integrale e tij.

2.a) Teksti i referuar në paragrafin 1(a)(i) është në dy kopje autentike, në gjuhët angleze dhe frënge, të depozituara në kohën kur kjo Marrëveshje është hapur për firmosje, një te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe tjetra te Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (më poshtë respektivisht “Drejtori i Përgjithshëm” dhe “Organizata”) të vendosura nga Konventa e 14 korrikut 1967.

b) Amendamentet e referuara në paragrafin 1(a) (ii) do të depozitohen në dy kopje autentike, në gjuhët angleze dhe frënge, një te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe tjetra te Drejtori i Përgjithshëm.

c) Amendamentet e referuara në paragrafin 1(a)(iii) do të depozitohen në një kopje autentike, në gjuhët angleze dhe frënge, te Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 3

Gjuhët e Klasifikimit

1. Klasifikimi do të vendoset në gjuhët angleze dhe frënge, duke qenë të dyja tekstet autentike.

2. Tekstet zyrtare të Klasifikimit, në gjermanisht, japonisht, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe në gjuhë të tjera që Asambleja mund të përcaktojë mbështetur në nenin, do të vendosen nga Byroja Ndërkombëtare e Organizatës (Byroja Ndërkombëtare) në konsultime me qeveritë e interesuara ose mbi bazën e përkthimit të depozituar nga këto qeveri ose përmes mjeteve të tjera që nuk krijojnë pasoja financiare për buxhetin e Unionit Special ose për Organizatën.

Neni 4

Përdorimi i Klasifikimit

1. Klasifikimi do të jetë vetëm i karakterit administrativ.

2. Çdo vend i Unionit Special ka të drejtë të përdorë Klasifikimin si sistem kryesor ose sekondar.

3. Autoritetet kompetente të vendeve të Unionit Special do të përfshijnë në të:

iv) patentat, certifikatat e shpikësve, certifikatat e modeleve dhe ato të përdorimit të lëshuara prej tyre, dhe aplikimet që kanë lidhje me to, të publikuara ose vetëm për inspektimin publik prej tyre, dhe

v) njoftimet që shfaqen në periodikët zyrtarë të publikimit ose të hapura për dokumentet e referuara në nënparagrafin (i) simbolet komplete të Klasifikimit të zbatuara në shpikje dokumentet e së cilës i referohet nënparagrafi (i).

4. Kur nënshkruhet kjo Marrëveshje ose kur depozitohen instrumentet e saj të ratifikimit ose hyrjes:

i) secili vend mund të deklarojë se nuk merr përsipër të përfshijë simbolet që kanë lidhje me grupe ose nëngrupe të Klasifikimit në aplikime sipas paragrafit (3) që janë hapur vetëm për inspektim publik dhe në njoftimet që kanë lidhje me to, dhe

ii) secili vend që nuk bën ekzaminimin për risi dhe në të cilin procedurat për lëshimin e patentave ose forma të tjera mbrojtjeje nuk parashikojnë hetim të gjendjes aktuale të shpikjes, mund të deklarojnë që ata nuk marrin përsipër të përfshijnë simbolet që kanë lidhje me grupe ose nëngrupe të Klasifikimit në aplikime sipas paragrafit (3). Nëse kushtet ekzistojnë vetëm për disa lloje mbrojtjeje ose disa fusha të teknologjisë, vendi në fjalë mund ta bëjë këtë objeksion kur aplikohen kushtet.

5. Simbolet e Klasifikimit, të paraprirë nga fjalët “Klasifikimi Ndërkombëtar i Patentave” ose shkurtimi i tyre për t’u përcaktuar nga Komiteti i Ekspertëve sipas nenit 5, printohet në formë të dukshme, ose në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të dukshme, në krye të çdo dokumenti sipas paragrafit (3)(i) në të cilët ato përfshihen.

6. Nëse çdo vend i Unionit Special ia beson lëshimin e patentës një autoriteti interqeveritar, ai

duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ky autoritet të përdorë Klasifikimin sipas këtij neni.

Neni 5

Komiteti i Ekspertëve

1. Një Komitet Ekspertësh do të ngrihet në secilin nga vendet e Unionit Special për ta përfaqësuar atë.

2.a) Drejtori i Përgjithshëm fton organizatat interqeveritare të specializuara në fushën e patentave, dhe që të paktën një prej vendeve anëtare është pjesë e kësaj Marrëveshjeje, të përfaqësohen me vëzhgues në mbledhjet e Komitetit të Ekspertëve.

b) Drejtori i Përgjithshëm mund, nëse kërkohet nga Komiteti i Ekspertëve, të ftojë përfaqësuesit e organizatave ndërqeveritare dhe të organizatave ndërkombëtare joqeveritare për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve që u interesojnë.

3. Komiteti i Ekspertëve:

i) do të amendojë Klasifikimin;

ii) do t'u drejtojë rekomandimet vendeve të Unionit Special, me qëllim lehtësimin e përdorimit të Klasifikimit dhe promovimit të aplikimit të tij uniform;

iii) do të asistojë në promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në riklasifikimin e dokumentacionit të përdorur për ekzaminimin e shpikjeve, duke konsideruar në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim;

iv) do të marrë të gjitha masat e tjera, të cilat pa pasoja financiare për buxhetin e Unionit Special të Organizatës, kontribuojnë për lehtësimin e planifikimit të Klasifikimit nga vendet në zhvillim;

v) do të ketë të drejtën për të vendosur për krijimin e nënkomiteteve dhe grupeve të punës.

4. Komiteti i Ekspertëve miraton rregullat e procedurës. Këto do të lejojnë për mundësinë e pjesëmarrjes së organizatave ndërqeveritare, sipas paragrafit 2 (a), që mund të kryejnë punë të konsiderueshme në zhvillimin e klasifikimit, në mbledhjet e nënkomiteteve dhe grupeve të punës.

5. Propozimet për amendimet e Klasifikimit mund të bëhen nga autoriteti kompetent i çdo vendi në Unionin Special, Byroja Ndërkombëtare, çdo organizatë ndërqeveritare e përfaqësuar në Komitetin e Ekspertëve sipas paragrafit 2(a) dhe çdo organizatë tjetër e ftuar në mënyrë speciale nga Komiteti i Ekspertëve për të bërë propozime. Propozimet i komunikohen Byrosë Ndërkombëtare që duhet t'ua dërgojë vendeve anëtare të Komitetit të Ekspertëve dhe vëzhguesve jo më vonë se dy muaj përpara sesionit të Komitetit të Ekspertëve ku propozimet duhet të merren në konsideratë.

6.a) Çdo anëtar i Komitetit të Ekspertëve ka një votë.

b) Vendimet e Komitetit të Ekspertëve kërkojnë shumicën e thjeshtë të vendeve që marrin pjesë dhe votojnë.

c) Çdo vendim që i përket një të pestës së vendeve që përfaqësohen dhe votojnë për një modifikim në strukturën bazë të Klasifikimit ose ka të bëjë me një punë kryesore të riklasifikimit kërkon një shumicë të tre të katërtave të vendeve që përfaqësohen dhe votojnë.

d) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

Neni 6

Notifikimi, hyrja në fuqi dhe publikimi i amendamenteve dhe vendimeve të tjera

1. Çdo vendim i Komitetit të Ekspertëve në lidhje me miratimin e amendamenteve të Klasifikimit dhe rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve do t'u bëhet autoriteteve kompetente të vendeve të Unionit Special nga Byroja Ndërkombëtare. Amendamentet do të hyjnë në fuqi gjashtë muaj pas datës së njoftimit.

2. Byroja Ndërkombëtare do të fusë në Klasifikim amendamentet që kanë hyrë në fuqi. Njoftimet për amendamentet do të publikohen në botimet periodike të caktuara sipas nenit 7.

Neni 7

Asambleja e Unionit Special

1.a) Unioni Special do të ketë një Asamble që përbëhet nga vendet e Unionit Special.

b) Qeveritë e secilit vend të Unionit Special do të përfaqësohen nga një delegat, që mund të

asistohet nga delegatë të alternuar, këshilltarë dhe ekspertë.

c) Çdo organizatë ndërqeveritare sipas nenit 5 (2) (a) mund të përfaqësohet nga një vëzhgues në mbledhjet e Asamblesë dhe nëse Asambleja vendos, në komitetet ose grupet e punës që mund të vendosen nga Asambleja.

d) Shpenzimet e secilit delegacion përballohen nga qeveria që e ka vendosur atë.

2.a) Në përputhje me dispozitën e nenit 5, Asambleja:

i) do të trajtojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe zhvillimin e Unionit Special dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

ii) do t'i japë drejtimit Byrosë Ndërkombëtare në lidhje me përgatitjen e konferencave për rishikimin e Klasifikimit;

iii) do të rishikojë dhe miratojë raportet dhe aktivitetet e Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me Unionin Special, dhe do t'i japë atij të gjitha instruksionet në lidhje me çështjet e Unionit Special;

iv) do të përcaktojë programin dhe do të miratojë buxhetin dyvjeçar të Unionit Special, dhe do të miratojë bilancin final të tij;

v) do të miratojë rregullat financiare të Unionit Special;

vi) do të vendosë për tekstet zyrtare të Klasifikimit në gjuhët përveç anglishtes, frëngjishtes dhe atyre në listën e nenit 3 (2);

vii) do të vendosë për komitetet dhe grupet e punës që i gjykon të përshtatshme për të arritur objektivat e Unionit Special;

viii) do të përcaktojë, sipas paragrafit 1(c), cilat vende joanëtare të Unionit Special dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen si vëzhguese në mbledhjet e saj, dhe në ato të secilit komitet ose grup pune të vendosur prej saj;

ix) do të marrë çdo veprim tjetër të përshtatshëm për të orientuar më tej objektivat e Unionit Special;

x) do të kryejë funksione të tjera që janë të përshtatshme në këtë Marrëveshje.

b) në lidhje me çështje që janë me interes edhe unionet e tjera të administruara nga Organizata, Asambleja do të marrë vendimet e saj pasi të ketë dëgjuar Komitetin Koordinues të Organizatës.

3. a) Çdo vend anëtar i Asamblesë do të ketë një votë.

b) Gjysma e vendeve anëtare të Asamblesë do të përbëjë kuorumin.

c) Në mungesë të kuorunit, Asambleja mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me procedurat e saj, këto vendime do të kenë efekt nëse plotësohen kushtet e vendosura më poshtë. Byroja Ndërkombëtare do t'u komunikojë vendimet vendeve anëtare të Asamblesë që nuk janë përfaqësuar dhe do t'i ftojë ato të shprehin me shkrim votën e tyre ose abstenimin në një periudhë tremujore nga data e komunikimit. Nëse pas mbarimit të kësaj periudhe numri i vendeve që kanë shprehur votën e tyre ose abstenimin përbëjnë numrin e vendeve që munguan për të përbërë kuorumin në sesion, këto vendime marrin efekt duke siguruar në të njëjtën kohë shumicën e kërkuar.

d) Sipas dispozitave të nenit 11(2), vendimet e Asamblesë do të kërkojnë dy të tretat e numrit të votave.

e) Abstenimet nuk do të konsiderohen vota.

f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe votojë në emër vetëm të një vendi.

4.a) Asambleja mblidhet një herë në çdo vit të dytë kalendarik në sesion të zakonshëm nga Drejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës.

b) Asambleja do të mblidhet në sesion të jashtëzakonshëm nga Drejtori i Përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së vendeve anëtare të Asamblesë.

c) Axhenda e çdo sesioni do të përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Asambleja do të miratojë rregullat e procedurës.

Neni 8

Byroja Ndërkombëtare

1. a) Detyrat administrative që kanë të bëjnë me Unionin Special do të paraqiten nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Në mënyrë të veçantë, Byroja Ndërkombëtare do të përgatisë mbledhjet dhe do t'i sigurojë Sekretariatit të Asamblesë, Komitetit të Ekspertëve dhe komiteteve të tjera ose grupeve të punës që mund të vendosen nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm do të jetë Shefi Ekzekutiv i Unionit Special, dhe do të përfaqësojë

Unionin Special.

2. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar i stafit të caktuar nga ai do të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, Komitetit të Ekspertëve dhe komiteteve të tjera ose grupeve të punës që mund të vendosen nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve. Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar i stafit të caktuar prej tij, do të jetë sekretar *ex officio* i këtyre organeve.

3.a) Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me drejtimit e Asamblesë, do të bëjë përgatitjen e rishikimit të konferencave.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe joqeveritare për përgatitjet për rishikimin e konferencave.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet për rishikimin e konferencave.

4. Byroja Ndërkombëtare do të kryejë çdo detyrë tjetër të caktuar asaj.

Neni 9 Financat

1. a) Unioni Special ka një buxhet.

b) Buxheti i Unionit Special përfshin të ardhurat dhe shpenzimet e Unionit Special, kontributin në buxhet të shpenzimeve të përbashkëta dhe, kur është e aplikueshme, shumën që duhet për buxhetin e Konferencës së Organizatës.

c) Shpenzimet që nuk i atribuohen ekskluzivisht Unionit Special, por gjithashtu një ose më shumë unioneve të administruara nga Organizata, do të konsiderohen si shpenzime të përbashkëta të unioneve. Ndarja për Unionin Special e këtyre shpenzimeve të përbashkëta do të jetë në raport me interesat që Unioni Special ka për to.

2. Buxheti i Unionit Special do të caktohet duke marrë parasysh kërkesat për koordinimin me buxhetet e unioneve të tjera të administruara nga Organizata.

3. Buxheti i Unionit Special do të financohet nga burimet e mëposhtme:

i) kontributet e vendeve të Unionit Special;

ii) taksat dhe pagesat për shërbimet që bëhen nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin Special;

iii) shitja ose detyrimet për publikimet e Byrosë Ndërkombëtare për Unionin Special;

iv) dhuratat, donacionet dhe subvencionet;

v) qiratë, interesat dhe të ardhura të tjera të ndryshme.

4. a) Për qëllim të caktimit të kontributit të tij referuar në paragrafin 3 (i), çdo vend anëtar i Unionit Special do të jetë në të njëjtën klasë të Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe do të paguajë kontributin e tij vjetor në bazën e të njëjtit numër të njësive të fiksuara në atë klasë të atij Unioni.

b) Kontributi vjetor i secilit vend të Unionit Special do të jetë një sasi në të njëjtin proporcion me shumën totale të kontributit në Unionin Special nga të gjitha vendet si numër i njësive të tij në totalin e njësive të vendeve kontribuese.

c) Kontributet duhen derdhur në 1 janar të çdo viti.

d) Një vend që ka prapambetje në pagesën e kontributeve të tij nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në secilin organ të Unionit Special nëse sasia e prapambetjeve të tij është e barabartë ose e kalon sasinë e kontributeve të tij për dy vjet. Megjithatë, çdo organ i Unionit Special mund të lejojë çdo vend të vazhdojë të ushtrojë të drejtën e votës në atë organ nëse, sado gjatë të jetë, ai provon që mungesa në pagesë është për shkak të rrethanave të veçanta dhe të pashmangshme.

e) Nëse buxheti nuk miratohet përpara fillimit të një periudhe financiare, ai do të jetë në të njëjtin nivel si buxheti i vitit të mëparshëm, siç parashikohet në rregullat financiare.

5. Sasia e taksave dhe e pagesave për shkak të shërbimeve të kryera nga Byroja Ndërkombëtare për Unionin Special do të caktohet dhe do t'i raportohet Asamblesë nga Drejtori i Përgjithshëm.

6.a) Unioni Special do të ketë një fond kapital pune që do të caktohet nga një pagesë e vetme e bërë nga çdo vend i Unionit Special. Nëse fondi rezulton i pamjaftueshëm, Asambleja do të vendosë rritjen e tij.

b) Sasia e pagesës fillestare të çdo vendi në këtë fond ose pjesëmarrja e tij në rritjen e tij do të jetë pjesë e kontributit të këtij vendi për vitin në të cilin fondi është caktuar ose është marrë vendimi për rritjen e tij.

c) Pjesa dhe termat e pagesës do të fiksohen nga Asambleja me propozim të Drejtorit të

Përgjithshëm pas dëgjimit të këshillës së Komitetit Koordinues të Organizatës.

7. a) Në marrëveshjet në zyrat qendrore të mbyllura me vendin në territorin e të cilit Organizata ka zyrë qendrore të saj, do të sigurohet që, kur fondi i kapitalit të punës është i pamjaftueshëm, ky vend do ta japë atë paraprakisht. Sasia e këtyre parave dhe kushtet në të cilat ato jepen do të jenë subjekt i marrëveshjeve të veçanta, në secilin rast, midis këtij vendi dhe Organizatës.

b) Vendi që referohet në nënparagrafin (a) dhe Organizata secili do të ketë të drejtën të denoncojë detyrimin për dhënien e shumave paraprake, në formë të shkruar. Denoncimi do të marrë efekt tre vjet pas fundit të vitit në të cilin është rënë dakord në formë të shkruar.

8. Auditimi i llogarisë do të bëhet nga një ose më shumë vende të Unionit Special ose nga auditorë të jashtëm, si parashikohet në rregullat financiare. Ata caktohen me vullnetin e tyre ose nga Asambleja.

Neni 10

Rishikimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të rishikohet herë pas here nga një konferencë speciale e vendeve të Unionit Special.

2. Thirrja e çdo konference për rishikim do të vendoset nga Asambleja.

3. Nenet 7, 8, 9 dhe 11 mund të amendohen nga një konferencë rishikimi ose në bazë të dispozitave të nenit 11.

Neni 11

Amendimi i disa dispozitave të Marrëveshjes

1. Propozimet për amendimin e nenit 7, 8, 9 dhe 11 të kësaj Marrëveshjeje neni mund të fillohen nga çdo vend i Unionit Special ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto propozime do t'u komunikohen nga Drejtori i Përgjithshëm vendeve të Unionit Special të paktën gjashtë muaj përpara marrjes së tyre në konsideratë nga Asambleja.

2. Amendamentet e neneve sipas paragrafit (1) do të miratohen nga Asambleja. Miratimi do të kërkojë tre të katërtat e numrit të votave duke siguruar që çdo amendament i nenit 7 dhe këtij paragrafi do të kërkojë katër të pestat e numrit të votave.

3.a) Çdo amendament në nenet e referuara në paragrafin (1) do të hyjë në fuqi një muaj pasi notifikimi në formë të shkruar të pranimit të tij, kryer në përputhje me proceset respektive kushtetuese, nga tre të katërtat e vendeve anëtare të Unionit Special në kohën që amendamenti është miratuar, është marrë nga Drejtori i Përgjithshëm.

b) Çdo amendament në nenet e përmendura është detyrues për të gjitha vendet që janë anëtare të Unionit Special në kohën që amendamenti hyn në fuqi, duke siguruar që çdo amendament që rrit detyrimet financiare të vendeve të Unionit Special do të detyrojë vetëm ato vende që kanë njoftuar pranimin e këtij amendamenti.

c) Çdo amendament i pranuar në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (a) është detyrues për të gjitha vendet që bëhen anëtare të Unionit Special pas datës në të cilën amendamenti ka hyrë në fuqi në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (a).

Neni 12

Bërja palë në këtë Marrëveshje

1. Çdo vend palë i Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale mund të bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje duke:

- i) nënshkruar e depozituar instrumentin e ratifikimit, ose
- ii) depozituar instrumentin e aderimit.

2. Instrumentet e ratifikimit ose të aderimit do të depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm.

3. Dispozitat e nenit 24 të Aktit të Stokholmit të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale do të aplikohen në këtë Marrëveshje.

4. Paragrafi (3) do të kuptohet si implikim i njohjes nga një vend i Unionit Special, të situatës faktike në territorin e një vendi tjetër në të cilin kjo Marrëveshje është aplikuar nga një vend tjetër sipas këtij paragrafi.

Neni 13

Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje

1.a) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi një vit pas depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose aderimit nga:

i) dy të tretat e vendeve të Konventës Europiane në datën në të cilën kjo Marrëveshje është e hapur për firmosje, dhe

ii) tri vende të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale që nuk kanë qenë më parë pjesë e Konventës Europiane nga të cilët të paktën një është vend ku, sipas statistikave vjetore më të fundit, në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit janë aplikuar më shumë se 40 000 aplikime për shpikje ose patenta.

b) Në lidhje me çdo vend përveç atyre për të cilat kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi sipas nënparagrafit (a), ajo do të hyjë në fuqi një vit pas datës në të cilën ratifikimi ose aderimi përkatës i njoftohet Drejtorit të Përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur një datë e mëvonshme përcaktohet në instrumentin e ratifikimit ose aderimit. Në rastin e fundit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi për këtë vend në datën e treguar.

c) Vendet pjesë e Konventës Europiane që ratifikojnë këtë Marrëveshje ose aderojnë në të janë të detyruara të denoncojnë Konventën jo më vonë se data në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi për këto vende.

2. Ratifikimi ose aderimi do të thotë pranim automatikisht i të gjitha dispozitave përfitim nga të gjitha avantazhet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje do të ketë të njëjtën kohëzgjatje si Konventa e Parisit për Mbrojtjen e pronësisë industriale.

Neni 15

Denoncimi

1. Çdo vend i Unionit Special mund të denoncojë këtë Marrëveshje përmes njoftimit drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Denoncimi do të ketë efekt një vit pas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka marrë njoftimin.

3. E drejta e denoncimit e siguruar nga ky nen nuk do të ushtrohet nga asnjë vend përpara kalimit të pesë vjetëve nga data në të cilën është bërë anëtar i Unionit Special.

Neni 16

Nënshkrimi, gjuhët, notifikimi, funksionet e depozitarit

1.a) Kjo Marrëveshje do të nënshkruhet në një origjinal në gjuhët angleze dhe frënge, duke qenë të dyja tekstet autentike.

b) Kjo Marrëveshje do të qëndrojë e hapur për nënshkrim në Strasburg deri në 30 shtator 1971.

c) Origjinali i kësaj Marrëveshjeje, kur nuk është më i hapur për nënshkrim, do të depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm.

2. Tekstet zyrtare do të vendosen nga Drejtori i Përgjithshëm pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjermanisht, japonisht, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe gjuhë të tjera që mund të vendosë Asambleja.

3.a) Drejtori i Përgjithshëm i dërgon dy kopje të vërtetuara të tekstit të nënshkruar të kësaj Marrëveshjeje qeverive të vendeve që e kanë nënshkruar atë dhe sipas kërkesës, qeverisë së çdo vendi tjetër. Ai i dërgon një kopje të vërtetuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

b) Drejtori i Përgjithshëm i dërgon dy kopje të vërtetuara të çdo amendamenti të kësaj Marrëveshjeje qeverive të të gjitha vendeve të Unionit Special dhe, sipas kërkesës, qeverisë së çdo vendi tjetër. Ai i dërgon një kopje të vërtetuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

c) Drejtori i Përgjithshëm, sipas kërkesës, i dërgon çdo qeverie që ka nënshkruar këtë Marrëveshje, ose që ka aderuar në të, një kopje të Klasifikimit të vërtetuar nga ai, në gjuhët anglisht ose frëngjisht.

4. Drejtori i Përgjithshëm do të regjistrojë këtë Marrëveshje në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara.

5. Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë qeveritë e të gjitha vendeve pjesë të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale dhe Sekretariatin e Këshillit të Europës për:

- i) nënshkrimet;
- ii) depozitimet e instrumenteve të ratifikimit ose aderimit;
- iii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;
- iv) të drejtat e përdorimit të Klasifikimit;
- v) pranimet e amendamenteve të kësaj Marrëveshjeje;
- vi) data në të cilat këto amendamente do të hyjnë në fuqi;
- vii) denoncimet e marra.

Neni 17

Dispozita kalimtare

1. Gjatë dy vjetëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, vendet pjesë e Konventës Europiane që nuk janë ende anëtare të Unionit Special mund të gëzojnë, nëse dëshirojnë, të njëjtat të drejta në Komitetin e Ekspertëve sikur të ishin anëtarë të Unionit Special.

2. Gjatë tre vjetëve pas kalimit të periudhës së referuar në paragrafin (1), vendet e referuara në këtë paragraf mund të përfaqësohen me vëzhgues në mbledhjet e Komitetit të Ekspertëve dhe, nëse Komiteti vendos, në çdo nënkomitet ose grup pune të vendosur nga ai. Gjatë së njëjtës periudhë ata mund të depozitojnë propozime për amendamente të Klasifikimit, në përputhje me nenin 5 (5), dhe do të njoftohen për vendimet dhe rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve, në përputhje me nenin 6(1).

3. Gjatë 5 vjetëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, vendet pjesë e Konventës Europiane që nuk janë ende anëtarë të Unionit Special mund të përfaqësohen me vëzhgues në mbledhjet e Komitetit të Ekspertëve dhe, nëse Komiteti vendos, në çdo nënkomitet ose grup pune të vendosur nga ai.

DEKRET

Nr.4906, datë 6.6.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Sejdi Qerimaj, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara dhe Organizatave të tjera Ndërkombëtare në Gjenevë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.4907, datë 6.6.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Thodharaq Laço, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Federatën Ruse, rezident, si dhe të Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Bjellorusi, Kazakistan, Uzbekistan, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 8.6.2006
Doli nga shtypi më 13.6.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë